

# PYETJET QË HASEN MË SHPESH (FAQ)

## **Si mund të njihem me kriteret e pranimit për shkollat e mesme me Pranim nga Gjithë-Qyteti, me Pranim Special dhe të Përgjithëshme?**

Kriteret e pranimit për shkollat e mesme me pranim special dhe nga i gjithë qyteti, mund të gjenden në direktorinë e Shkollave të Mesme. Ju mund të futeni në këtë direktori, online në Zyrën e Rregjistrimit & Vendosijes së Nxënësve (<http://webgui.phila.k12.pa.us/offices/s/student-placement>) dhe klikoni vendin e duhur. Ju mund të pyesni edhe këshilltarin e shkollës tuaj.

## **Ku mund të gjej një listë të shkollave që kanë programe për AS, ES, LSS? (Vetëm Edukim Special)**

Kërkesa e një liste të shkollave të mesme me programe (AS, ES, LSS, etj) mund të jetë në kundërshtim me praktikën e Shkollës sipas procesit "LeGare". Të gjitha shkollat tona ose mbështesin individualisht nxënësit me pa aftësi, ose kanë program për nxënësit me pa aftësi.

## **Si mund ta ndihmoj fëmijën tim për aplikimin?**

Prindërit duhet: 1) Ta çojnë fëmijën në Panairin e Shkollës së Mesme; 2) Të zgjedhin shkollën e mesme bazuar në mundësitë dhe interesin; 3) Të përftojnë rekomandime nga jashtë shkollës; 4) Të bashkëpunojnë me fëmijën për esetë; 5) Të dërgojnë në kohë të këshilltari i shkollës TË GJITHA materialet e aplikimit 6) Të punojnë me këshilltarin për planifikimin e intervistave, ose audicioneve; 7) Të çojnë në kohë fëmijën në intervista dhe audicione.

## **Si mund të pyes për heqjen e ndonjë kriteri për pranim?**

Rrëzimi i ndonjë kërkesë për pranim mund të bëhet në rast se ka evidenca të dokumentuara të rrethanave lehtësuese (p.sh.: mungesa për shkak shtrimi në spital).

## **Si mund t'a mësoj që fëmija im është pranuar në shkollë të mesme me pranim nga i gjithë qyteti, me pranim special, ose me program CTE?**

Letra e vendimit do të dërgohet në shtëpi me tregues të pranimit ose të refuzimit. Vendimi për refuzim do të ketë të treguara edhe arsyet e këtij vendimi.

## **Çfarë është Seanca Dëgjimore e Paanëshme? Si mund ta di që fëmija im ka mundësinë për një Seancë të tillë Dëgjimore?**

Seanca Dëgjimore e Paanëshme është një vlerësim i fundit për nxënësit me IEP's, Plan 504 dhe ata ELL, që kanë aplikuar dhe nuk janë pranuar në programet CTE, shkollat me pranim nga i gjithë qyteti, ato me pranim special. Seanca Dëgjimore e Paanëshme nuk aplikohet për shkollat e tjera të përgjithëshme (përveç ato me program CTE), shkollat charter, ose shkolla që nuk janë të Drejtorisë Arsimore. Nxënësve u mundësohet kjo përmes një letre me udhëzime, se si të kërkojnë Seancë Dëgjimore të Paanëshme.